



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 1 gusht 2017

Ref. Nr: 154/018

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), neneve 5 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17/16, shtator 2011), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet zbatimi i dokumenteve “Korniza e Kurikulës së Kosovës”, “Kurikulat Bërtham” dhe “Programet mësimore” në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2017/2018.
2. Aprovohet zbatimi i programeve mësimore: Klasa e dytë (2), klasa shtashtë (7), klasa njëmbdhjetë (11) për gjimnaze në të gjitha shkollat pilot në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi për zbatim në vitin shkollor 2017/2018.
3. Të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim dhe të gjitha shkollat e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës bëjnë përgaditjet për zbatim në shkolla, të programeve mësimore sipas Korniza e Kurikulës së Kosovës në vitin shkollor 2017/2018.
4. Përgaditjet përfshijnë:
 - 4.1. Informimin dhe senzibilizimin e komunitetit arsimor të shkollës me programe të reja lëndore;
 - 4.2. Riorganizimin e organeve profesionale të shkollës;

- 4.3. Përcaktimin e mësimdhënësve që do të punojnë me klasët të përcaktuar në pika 2 për zbatimin e programit mësimor;
- 4.4. Përgaditjet e planit vjetor, periodik, mujor, javor dhe ditor, në zbatim të programit mësimor për klasë.
5. Me zbatimin e programit mësimor për klasët: 0, 1, 6, 10 për gjimnaze në shkollë, shfuqizohen programet mësimor të deritashme për këto kasë.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamentet e Divizionet përgjegjëse të MASHT-it për zbatimin e saj.
7. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, kërkesës me nr. 8/2-2682 të dt. 26.07.2017 dhe pas realizimit të zbatimit të vendimit për nënshkrim dhe finalizimin e dokumentit, i cili proces ka qenë rezultat i zbatimit të programit mësimor në 95 shkolla të Kosovës, nga koordinatorët e MASHT-it, koordinatorët e DKA-ve për kurrikula, koordinatorët e cilësisë në shkolla, prindërit, trajnerët, nga projekti mbështetës i GIZ, nga vizita e shkollave pilotuese dhe nga raportet të propozimeve të hartimit të programeve lëndore, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Arsim BAJRAMI, ministër

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Iu dërgohet:

- Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit të Inspektimit të Arsimit/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore/MASHT;
- Drejtorive Komunale të Arsimit
- Arkivit/MASHT.